



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 55 prot.

Kamëz, më 17.7.2025

VENDIM

Nr. 47 Datë 17/7 2025

MBI

“EMËRTIMIN E NJË SHKOLLE 9-VJEÇARE NË TERRITORIN E BASHKISË
KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.07.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.42 Datë 16.07.2025 në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ll” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 43 i VKB. 33 date 21.03.2024 “Për Miratimin e Rregullores Për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Kamëz, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Emërtimin "Angela Merkel" të shkollës re, ndërtuar: Rruga, Bulevardi "Nënë Tereza", me kapacitet mbi 1000 nxënës, sipas fragmentit të hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi, shfuqizohet.
3. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

